

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.5/02), Këshilli i Komunës së Kërçovës në mbledhjen e mbajtur më dt. __.__.2019, solli:

V E N D I M I

Për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për përcaktimin e vlerave të tregut të patundshmërive në territorin e Komunës së Kërçovës

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi i Rregullores për përcaktimin e vlerave të tregut të patundshmërive në territorin e Komunës së Kërçovës me nr.07-2770/18 nga dt.23.09.2013.

Neni 2

Në nenin 2, paragrafi 2, pas fjalëve pikë për m², bëhet ndryshim dhe plotësim dhe zëvendësohet me **nga zona e pestë deri te zona e njëmbëdhjetë**, ndërsa për vendbanimet (fshatëra) janë të ndarë në katër grupe, duke filluar nga zona e dymbëdhjetë deri te zona e pesëmbëdhjetë e Metodologjisë.

Neni 3

Në nenin 3, paragrafi 2, fjala e pestë zëvendësohet me fjalën e gjashtë, fjala e gjashtë me fjalën e shtatë dhe fjala e njëmbëdhjetë zëvendësohet me fjalën e dymbëdhjetë dhe i njëjti do të thekson:

Zonate ndarjes së territorit të qytetit (në pajtim me pasqyrën grafike) do të përfshihen në pajtim me zonat sipas Metodologjisë në mënyrë që për zonën e parë të ndarjes së territorit të qytetit (në pajtim me pasqyrën grafike) do të përlllogariten pikat nga zona e pestë sipas Metodologjisë, për zonën e dytë të ndarjes së territorit të qytetit (në pajtim me pasqyrën grafike) do të përlllogariten pikat nga zona e gjashtë sipas Metodologjisë dhe gjithashtu në mënyrë adekuate deri në zonën e shtatë të ndarjes së territorit të qytetit (në pajtim me pasqyrën grafike), gjegjësisht zona e njëmbëdhjetë sipas Metodologjisë.

Neni 4

Në nenin 5, paragrafi 1, pas alinesë së gjashtë shtohet edhe alinea e shtatë:
Zona e shtatë 20-40 europër m²

Neni 5

Në nenin 6, paragrafi 1, fjala e pestë zëvendësohet me të gjashtë.

Neni 6

Në nenin 7, paragrafi 1, fjala tre zëvendësohet me fjalën katër, ndërsa grupet do të qëndrojnë:

GRUPI I PARË

I përfshin vendbanimet: Dërgovë, Sërbjan, Mafmute, Osoj, Reshtan, Trapçindoll, Strellcë (vendi i quajtur "Gara"), Llapkindoll i Poshtëm, Cërvicë dhe Kolibar.

GRUPI I DYTË

I përfshin vendbanimet: Bigor Dolencë, Vraneshnicë, Karbunicë, Staroec, Çellopek, Popollzhan, Zajaz (pjesë përgjatë rrugës magjistrale), Llazarofcë dhe Greshnicë.

GRUPI I TRETË

I përfshin vendbanimet: Atishtë, Miokaz, Bërzhdan, Vidran, Dobrenoec i Poshtëm, Izvor, Kozicë, Dolencë e Manastirit, Podvis, Svinjishtë, Drogomisht i Madh, Drogomisht i Vogël, Zajaz (pjesa jashtë rrugës magjistrale), Kollarë, Haranjell, Zhubrinë, Jagoll, Jagoll Dolencë, Popojan, Osslome, Sërbicë, Shutovë, Tuhin dhe Garanë.

GRUPI I KATËRT

I përfshin vendbanimet: Dupjan, Kozicinë, Krushicë, Orllancë, Pateec, Rabetinë, Reçan-I Çellopekut, Svetoraçë, Belicë, Cërskoi Madh, Dushegubicë e Epërme, Dobrenoeci Epërm, Dughegubicë e Poshtme, Ehlloec, Ivançishtë, Javorec, Judovë, Klladnik, Klenoec, Llavçan, Mallkoec, Cërskoi Vogël, Prostranjë, Cer, Baçisht, Bukojçan, Llapkindoll (Trebiçevë dhe Llapkindolli Epërm), Leshnicë, Midincë, Reçan-I Zajazit, Tajmisht, Berikovë, Garanë, Novosell, Prapadisht, Premkë dhe Tuhin-Kaleshe.

Neni 7

Në nenin 8, në pasqyrën tabelare, shtohet rendi i katërt, i cili do të thekson:

IV	150 - 300
-----------	------------------

Neni 8

Në nenin 11, paragrafi 1, fjala tre zëvendësohet me fjalën katër, ndërsa zonat do të theksojnë:

ZONA I

I përfshin qytetin e Kërçovës dhe vendbanimet: Dërgovë, Sërbjan, Mafmute, Osoj, Reshtan, Trapçindoll, Strellcë (vendi i quajtur "Gara"), Llapkindoll i Poshtëm, Cërvicë dhe Kolibar.

ZONA II

I përfshin vendbanimet: Bigor Dolencë, Vraneshnicë, Karbunicë, Staroec, Çellopek, Popollzhan, Zajaz (pjesë përgjatë rrugës magjistrale), Lllazarofcë dhe Greshnicë.

ZONA III

I përfshin vendbanimet: Atishtë, Miokaz, Bërzhdan, Vidran, Dobrenoec i Poshtëm, Izvor, Kozicë, Dolencë e Manastirit, Podvis, Svinjishtë, Drogomisht i Madh, Drogomisht i Vogël, Zajaz (pjesa jashtë rrugës magjistrale), Kollarë, Haranjell, Zhubrinë, Jagoll, Jagoll Dolencë, Popojan, Osslome, Sërbicë, Shutovë, Tuhin dhe Garanë.

ZONA IV

I përfshin vendbanimet: Dupjan, Kozicinë, Krushicë, Orllancë, Pateec, Rabetinë, Reçan-I Çellopekut, Svetoraçë, Belicë, Cërskoi Madh, Dushegubicë e Epërme, Dobrenoeci Epërm, Dughegubicë e Poshtme, Ehlloec, Ivançishtë, Javorec, Judovë, Klladnik, Klenoec, Llavçan, Mallkoec, Cërskoi Vogël, Prostranjë, Cer, Baçisht, Bukojçan, Llapkindoll (Trebiçevë dhe Llapkindolli Epërm), Leshnicë, Midincë, Reçan-I Zajazit, Tajmisht, Berikovë, Garanë, Novosell, Prapadisht, Premkë dhe Tuhin-Kaleshe.

Neni 9

Në nenin 12, në pasqyrën tabelare, shtohet kolonë shtesë, e cila do të theksojë:

ZONA e katërt	
Kateg. 1	Kateg. 2
den./m²	den./m²
150	140
140	130
130	120
120	110
110	100
100	90
80	70
60	50

Neni 10

Shtohet nen i ri 13, i cili thekson:

Përcaktimi i vlerës së tregut në zonën ekstra

Neni 13

I përfshin sipërfaqet bujqësore që për shkak të vendpozitës së tyre, qasjes më të lirë ose planifikimit të ardhshëm të hapësirës dhe mundësisë për ridestinim kanë atraktivitet më të madh, në dallim me parcelat tjera fqinje, ndërsa ato janë tokë që kufizojnë ose janë në afërsi, të caktuar sipas shtojcës grafike në shtojcë të këtij Vendimi, me objekte të industrisë së madhe, zona të lira industriale, xeherore, pjesë të autostradave, rrugë lidhëse, pompa benzini, objekte për veprimtari shërbyese, hotele, motele, pushimore, qendra tregtare ose objekte tjera më të mëdha tregtare, vendparkime, centrale fotovoltaike dhe hidrocentrale, park të mullinjve me erë, burime, lumenjë...

Neni 11

Neni 13 bëhet neni 14, neni 14 bëhet neni 15, neni 15 bëhet neni 16, neni 16 bëhet neni 17.

Neni 12

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në Fletoren zyrtare të Komunës së Kërçovës.

Nr. _____ Këshilli i Komunës së Kërçovës

Dt. _____ .2023 Kryetar,

Kërçovë Skender Xhabiri

Në shtojcë të këtij vendimi, Ju bashkangjisim tekstin e spastruar të Propozimrregullores për përcaktimin e vlerave të tregut të patundshmërive në territorin e Komunës së Kërçovës.